



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

KONTRAKTORI "NDËRTIMI" Shpk, Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson z. Qaush Berisha, me Nr. Rexh. Unik i Biznesit, 810421058 (në vazhdim Kontraktuesi), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara më poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

KUBËZIMI I TROTUARËVE NË SARADRAN – ORROBERDË - KALIQAN

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-4535-5-2-1/ C 388</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020/ 058 / 521</i>

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

KUBËZIMI I TROTUARËVE NË SARADRAN – ORROBERDË - KALIQAN

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit: KUBËZIMI I TROTUARËVE NË SARADRAN – ORROBERDË - KALIQAN është: 14.681,00 € dhe me fjalë: /Katërmëdhjetëmijëegjashtëçindetëdhjetënjëeuro€

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës
Procesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresi

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i përmbushjes së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 30 ditësh, nga data e nënshkrimit të se njëjtës, përkatësisht me së larti deri me: 15.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit

Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për: Kontraktuesin:
"NDËRTIMI" Shpk

Emri:	Gëzim Ademaj	Emri: Për	Qaush Berisha
Pozita:	U.D. Menaxher-it i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.10.2020	Data:	26.10.2020
Vu la		Vu la	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës</i> 10% e vlerës së kontratës, me vlefshmeri 30 dite me gjate perfundimi i kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>1muaj</i>
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>5DITE</i> pas nënshkrimit të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

KOMUNA E ISTOGUT					
TITULLI I AKTIVITETIT					
PARAMASA- Kubëzimi i trotuareve Saradran L=225m d=1.2m Orroberdë L=375m,d=d=1m, Studenicë L=80m d=1.2m					
	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	Punët përgaditore				5,798.00
1.1	Germimi i shtresës së humusit për tërë sipërfaqen e planifikuar dhe atë me trashësi d=30cm	m³	306	2.00	612.00
1.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit 0-62mm me trashësi t=20cm për krijimin e shtresës tamponike. Në llogari të parashihet ngjeshja me cilindër	m³	204	6.00	1,224.00
1.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit 0-31.5mm me trashësi t=10cm për krijimin e shtresës së dytë tamponike. Në llogari të parashihet ngjeshja me cilindër	m³	102	6.00	612.00
1.4	Furnizimi dhe vendosja e rrerës për nivelizimin e terrenit për vendosjen e kubezave	m³	50	6.00	300.00
1.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave nga polietileni për gjatë kanalit kullues në Orroberdë me gjatësi L=200m Ø315mm dhe kanalit kullues në Studenicë me gjatësi L=70m dhe profil Ø250mm. Në llogari të parashihen edhe aktivitetet e nevojshme paraprake, si germimi i kanalit, vendosja e gypit dhe mbulimi i kanalit				
	Gypi PNS8 Ø315mm	m'	200	10.00	2,000.00
	Gypi PNS8 Ø250mm	m'	70	10.00	700.00
1.6	Furnizimi dhe montimi i 5 pusetave nga betoni e duke llogaritur në Gyp të betonit, konus, kapak dhe punimi i kinetave për puseta	copë	5	70.00	350.00
2	Kubëzimi				8,587.0 €
2.1	Furnizimi dhe vendosja e Kubezave të betonit me trashësi t=8cm dhe sipas standardeve, për tërë sipërfaqen e paraparë për kubëzim. Për formën dhe ngjyrën e kubezave vendos investitori (konsultim me organin mbikqyrës). Po ashtu të planifikohet edhe një ramje 1-2% ka pjesa e kanalit për tërë sipërfaqen e pjesës së trasës e cila parashihet të kubëzohet, e po ashtu të planifikohen hyrjet. Gjeresia e trotuarit të jetë d=1.5m	m²	741	7.0 €	5,187.0 €
2.2	Furnizimi me skajore 180x240x1000mm dhe vendosja e tyre në pjesën nga Asfalti. Në llogari të parashihen edhe përkrahjet e nevojshme e po ashtu të parashihet edhe betonimi i pjesës së demtuar ngjitur për Asfalt	m'	680	2.5 €	1,700.0 €
	Furnizimi me skajore 80x220x1000mm dhe vendosja e tyre në pjesën nga ana veriore. Në llogari të parashihen edhe përkrahjet e nevojshme	m'	680	2.5 €	1,700.0 €
3	Punët e dheut				136.0 €
3.1	Pastrimi i terrenit nga drunjët, shkurrët si dhe germimi dhe planifikimi i dheut të germuar nga pjesa e rruges dhe trasimi i trasës së trotuarit sipas nevojës, në llogari të futet edhe ngjeshja dhe kompaktësimi i dheut. Në llogari të parashihet edhe hapja e kanalit anesor-ekzistues	m	680	0.2 €	136.0 €
4	Punët montuese				160.0 €
4.2	Blerja, transporti dhe montimi i pusetave ujëmbledhëse (shahteve) në thellësi 60 cm të revizionit nga elementet e parafabrikuar të betonit tipike me profil rrethor, përfshirë edhe grilen me dimensione 40x40cm të gëzës për trafik të rëndë D-400KN. Ujëmbledhësit janë të paraparë të ndërtohen në rrugën Zallq-Shkollë- 4 copë dhe në rrugën Gurraçoc-Zallq	copë	4	40.0 €	160.0 €
TOTALI ME TË GJITHA NGARKESAT					14,681.0 €